



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 172 Akti

Nr. 202 Vendimi
Tiranë, më 6.11.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në datën 4.11.2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Përparim Kulluri** me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 24.9.2018, të trupit gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

4. Në datën 12.11.2018 subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin, në datën 13.11.2018 deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 18.10.2019, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, për të tria kriteret e rivlerësimit: kriterin e pasurisë, kriterin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e tij brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në datën 21.10.2019, subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit dhe në datën 28.10.2019 subjekti dërgoi me *e-mail* prapësimet dhe dokumentacionin referues, deklaratën noteriale nr. (***) datë 24.10.2019, të shtetasve G. Gj. dhe D. Gj., deklaratën noteriale nr. (***) të shtetasit M. D., si dhe kopje të listës së shpronësimit të Bashkisë Orikum.

7. Komisioni trajtoi kërkesën e subjektit të paraqitur në parashtrimet e tij që t’i mundësohej në bazë të ligjit, “Për informacionin e klasifikuar”, njohja me raportin e datës 18.12.2018, të Institucionit të DSIK-së. Komisioni, në datën 31.10.2019, me anë të postës elektronike i bëri

me dije subjektit se data e cituar prej tij korrespondon me datën e vendimit të DSIK-së për deklasifikimin e pjesëshëm të raportit, si dhe e informoi se nga pikëpamja ligjore, Komisioni nuk ka autoritetin për t'i dhënë të drejtën e njohjes ndaj informacionit të klasifikuar, për shkak se nuk e ka krijuar këtë informacion dhe as nuk e ka klasifikuar atë, si dhe mbi faktin se Komisioni ka hartuar rezultatet e hetimit mbi të gjitha provat e marra nga institucionet ligjzbatuese.

8. Në datën 31.10.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 4.11.2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

9. Në datën 4.11. 2019 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Përparim Kulluri. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 4.11.2019, për të rifilluar në datën 6.11.2019, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Përparim Kulluri ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (f) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin e saj të nivelit sekret me shkresën nr. (***) prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës.

Në lidhje me kërkesën nr. (***) prot., datë 19.11.2018, të Komisionit, për përditësimin dhe deklasifikimin e këtij raporti, DSIK-ja ka dërguar një raport të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. (***), datë 18.12.2018, të KDZH-së, **ku ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës, sipas së cilit ka rezultuar se:**

- Për subjektin e rivlerësimit administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar në krimin e organizuar.
- Institucionet verifikuese kanë informuar se: *Pas verifikimeve të kryera rezulton se disponohen të dhëna ku subjekti i rivlerësimit gjatë vitit 2012 dhe 2014 ka pasur kontakte të papërshtatshme/jorastësore. Disa nga këto z. Kulluri i ka pasur edhe nëpërmjet vëllait të tij, shtetasit E. K. .*
- Nga vlerësimi i informacioneve të siguruar nga institucionet verifikuese për subjektin e rivlerësimit dhe në zbatim të kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, neni 37, gjerat “b”, “c”, “ç”, neni 38, pika 4, gjerat “b”, “c”, “ç” “d”, pika 6, gjerat “a”, dhe “b”, bazuar në këto informacione për subjektin e rivlerësimit merret në konsideratë aktualiteti i të dhënës që evidenton rrethanat e konstatimit të faktit se z. Përparim Kulluri ka pasur kontakte të papërshtatshme/jorastësore për një periudhë relativisht të gjatë kohe.
- Gjithashtu, ekziston një kontakt i papërshtatshëm me person/persona (vëllai i subjektit) të përfshirë në krimin e organizuar (gjerat “b”, “ç” dhe “d”, të pikës 4, të nenit 38 dhe gjerat “a” dhe “b”, të pikës 6).
- Informacionet e përfuara nga autoritetet verifikuese e bëjnë subjektin një individ me tendencë për përfshirje në veprimtari kriminale dhe që mund të vihet lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale.

Pavarësisht rezultatit të paraqitur në raportin e DSIK-së, i mbështetur në informacione të marra nga strukturat përgjegjëse për kontrollin e figurës se ky subjekt është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, informacionet janë verifikuar nga Komisioni, veçanërisht në lidhje me faktet. Raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të tilla që mund ta bëjnë subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tyre. Për rrjedhojë, Komisioni ka kryer hetim të thelluar lidhur me informacionin e pasqyruar në raportin e DSIK-së, me qëllim vërtetësinë¹ dhe provueshmërinë e tij, i cili konsistoi sa parashirohet në vijim:

¹ KREU V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është autoritet përgjegjës për kontrollin e figurës për subjektet e rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin e figurës së subjektit, referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni mund dhe duhet të kryejë një hetim të thelluar. “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës

1. Anëtarët e trupit gjykues, së bashku me vëzhguesin ndërkombëtar, verifikuan dhe studiuat informacionet e klasifikuara, në bazë të të cilave është përpiluar raporti i DSIK-së. Këto informacione nuk mund t'i vihen të gjitha në dispozicion subjektit të rivlerësimit, pasi një pjesë e tyre janë të klasifikuara dhe në bazë të dispozitave ligjore, aksesit është i kufizuar.

2. Në raportin e DSIK-së, dërguar me shkresën nr. (***) prot., datë 2.11.2017, citohet: *“Institucionet verifikuese informojnë se pas verifikimeve të kryera rezulton se disponohen të dhëna..., ku subjekti i rivlerësimit, z. Përparim, gjatë vitit 2012 dhe 2014, ka pasur kontakte të papërshtatshme/jorastësore. Disa nga këto kontakte z. Përparim Kulluri i ka pasur edhe nëpërmjet vëllait të tij, shtetasit E. K.”.*

3. Vëzhguesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, në mendimin e tij përcjellë me shkresën nr. (***) prot., datë 17.9.2019, bazuar në pikën 11, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, ka parashtruar se gjatë hetimit për efekt rivlerësimi të subjektit të rivlerësimit, kanë rezultuar këto prova:

3.1 Ka informacion se shtetasi A. B., i njohur edhe si M. B., i lindur më 17.4.1972, ka qenë i proceduar penalisht në Greqi. Gjykata e Apelit Athinë ka urdhëruar arrestimin e tij më 11.5.2006, për veprën penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”.

3.2 Gjithashtu, shtetasi A. B., i njohur edhe si M. B., duke filluar nga data 24.1.2014, është hetuar penalisht për veprën penale “trafikim të lëndëve narkotike” nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, ku subjekti i rivlerësimit ka punuar nga tetori i vitit 2013, e në vazhdim.

3.3 Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike dhe trafikimi i lëndëve narkotike përbëjnë vepra penale të “krimit të organizuar”, siç përcaktohet nga pika 15, e nenit 3, të ligjit të nr. 84/2016. Për pasojë, A. B., i njohur ndryshe edhe si M. B., është “person i përfshirë në krimin e organizuar”, në bazë të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, nga data 11.5.2006, e në vijim.

3.4 Numri i telefonit (***) , i regjistruar në emrin e subjektit të rivlerësimit, është përdorur shpesh gjatë periudhës 15.3.2008 – 4.2.2016, për t'i telefonuar numrit të telefonit (***) , i cili ka qenë i regjistruar në emër të shtetasit A. B., i njohur edhe si M. B. .

3.5 Në periudhën nga viti 2012 deri në vitin 2013, nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar dhe ka kaluar kufirin shqiptar disa herë, duke drejtuar një autoveturë me targa (***) . Ky automjet rezulton se në këtë periudhë ka qenë në pronësi të shtetasit M. B. (i njohur edhe si A. B.), nga viti 2010 deri në vitin 2014. Subjekti i rivlerësimit ka pranuar se e ka përdorur automjetin jo vetëm për të kaluar kufirin, por edhe për qëllime të përgjithshme gjatë vitit 2012 dhe vitit 2013.

4. Në bazë të sa më sipër, vëzhguesi ndërkombëtar ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, ka pasur kontakt të papërshtatshëm me shtetasin A. B., i njohur edhe si M. B., person i përfshirë në krimin e organizuar, në bazë të germave “b” dhe “c”, të pikës 4, të nenit 38, si dhe nuk e ka plotësuar me saktësi dhe vërtetësi formularin e vetëdeklarimit të kontrollit të figurës, në shkelje të pikës 6, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.

rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi.”

5. Komisioni, në vijim të informacionit të disponuar, si dhe raportit të vëzhguesit ndërkombëtar, i ka kërkuar Zyrës së Gjendjes Gjyqësore² historikun e gjendjes penale të shtetasit A. B., i njohur edhe si M. B., nga ku ka rezultuar³ se ky shtetas ka qenë person me precedent penal, se ka pasur disa procedime penale për vepra të ndryshme penale të vrasjes me dashje në bashkëpunim, vrasjes me dashje në bashkëpunim të mbetur në tentativë dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, për të cilat edhe është dënuar.

6. Komisioni ka hetuar në lidhje me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me shtetasin A. B., i njohur edhe si M. B.:

6.1 Nga sistemi *TIMS* ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në vitin 2012 ka udhëtuar më shumë se në një rast, konkretisht gjashtë⁴ herë jashtë vendit, nga pika kufitare e Hanit të Hotit, në pozicionin e “shoferit” me automjetin me targa (***). Në këtë kohë, subjekti i rivlerësimit ushtronte funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

6.2 Në pyetësin standard subjekti i rivlerësimit ka deklaruar (në përgjigje të pyetjes nr. 5) se e ka përdorur këtë automjet, por pa konfirmuar pronarin e tij.

6.3 Subjekti i rivlerësimit është pyetur në lidhje me pronësinë e këtij automjeti, dokumentin me të cilin ka udhëtuar jashtë vendit, kohën në të cilën ka udhëtuar me këtë automjet, si dhe lidhur me marrëdhëniet e tij me pronarin e këtij automjeti.

6.4 Në përgjigjen e dhënë subjekti ka deklaruar⁵ se *automjetin ia ka marrë shtetasit M. D., se këtë shtetas e ka mik dhe se nuk mban mend të ketë paraqitur ndonjë dokument, përveç atij të mjetit, kur i është kërkuar. Po ashtu, subjekti ka deklaruar se me këtë automjet ai ka udhëtuar përgjatë vitit 2012 dhe 2013.*

6.5 Komisioni, nisur nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit, çmon se në çdo rast udhëtimi jashtë vendit, kur automjeti nuk është në pronësi të individit që e përdor atë, legjitimimi i përdoruesit të automjetit bëhet nëpërmjet aktit të përfaqësimit, që mund të jetë autorizim, aktpërdorim, etj. Subjekti deklaroi se nuk ka pasur një akt të tillë, por se ka paraqitur dokumentin e automjetit kur i është kërkuar.

6.6 DPSHTRR⁶-ja ka vënë në dispozicion dokumentacionin e automjetit, ku konfirmohet se automjeti me targa (***), ka qenë në pronësi të shtetasit M. B., i njohur edhe si A. B., që prej vitit 2010 (blerë në datën 8.6.2010, sipas faturës nr. (***)) deri në prill të vitit 2014 dhe më pas i është shitur shtetasit M. D. me kontratën e shitjes nr. (***), datë 2.4.2014.

6.6.1 Po në këtë praktikë rezultoi e administruar edhe shkresa⁷ e cila konfirmon se shtetasi A. B. ka ndryshuar emrin e tij nga A. në M., sipas vendimit nr. (***), datë 6.11.2009. Ky ndryshim është konfirmuar edhe me shkresën⁸ nr. (***)prot., datë 4.10.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

6.7 Pra, në çdo rast të paraqitjes së dokumentit zotërues të automjetit nga subjekti i rivlerësimit për udhëtimet e bëra prej tij në vitin 2012, konstatohet se leja e qarkullimit ka qenë në emër të shtetasit A. B., i njohur edhe si M. B. . Paraqitja e dokumentit identifikues të pronësisë së

² Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 26.9.2019, në dosjen e Komisionit.

³ Referojuni shkresës nr. (***)prot., datë 3.10.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴ Datë 29.2.2012 dalje, datë 8.3.2012 – 10.3.2012 dalje - hyrje, datë 31.3.2012 dalje - hyrje, datë 6.7.2012 dalje, datë 1.11.2012 hyrje, 20.12.2012 hyrje.

⁵ Referojuni përgjigjes së dhënë në datën 8.10.2019.

⁶ Referojuni praktikës së DPSHTRR-së ardhur me shkresën nr. (***) prot., datë 8.10.2019, në dosjen e Komisionit.

⁷ Datë 15.11.2011, e Bashkisë Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 5, në praktikën e DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

⁸ E administruar në dosjen e Komisionit nga korrespondenca e mbajtur me DPGJ-në Civile.

automjetit, me të cilin udhëtohet jashtë vendit (në këtë rast), është veprim i domosdoshëm i parashikuar nga legjislacioni.⁹

6.8 Komisioni e ka shtrirë hetimin në sistemin e AMF-së, por edhe duke kërkuar informacion në kompaninë “Vodafone”.

6.9 Nga sistemi i AMF-së ka rezultuar se ky automjet, në periudhën e përdorimit të tij nga subjekti i rivlerësimit, ka qenë në pronësi të shtetasit M. B., i njohur edhe si A. B., dhe jo të shtetasit M. D. .

6.9.1 Komisioni i ka kërkuar kompanisë “Vodafone” konfirmimin e identitetit që i përket numri i celularit (***), numër i identifikuar edhe në informacionin e vëzhguesit ndërkombëtar.

6.9.2 Kjo kompani ka vënë në dispozicion CD¹⁰-në përkatëse, pas verifikimit të të cilës ka rezultuar se ky numër celulari ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, kompania telefonike ka konfirmuar¹¹ edhe datën e hapjes së numrit në emër të subjektit të rivlerësimit, 15.3.2008, dhe datën e mbylljes, 4.2.2016, çka lë të nënkuptohet mundësinë e komunikimit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin B. në vitet 2012 dhe 2014, periudhë kjo e cilësuar për kontakte jo rastësore në raportin e DSIK-së.

6.10 Në bazë të këtij hetimi, Komisioni arriti në përfundimin se faktet e përmendura në raportet e DSIK-së, informacionet e dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe konstatimet e vëzhguesit ndërkombëtar, kanë lidhje me identifikimin e subjektit të rivlerësimit në kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, konkretisht në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

6.11 Në bazë të informacioneve që disponohen dhe që u hetuan, verifikuan dhe u studiuuan, Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të neneve Ç dhe DH, të Aneksit të Kushtetutës, i kaloi barrën e provës subjektit, pasi: dukej se kishte pasur kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, konkretisht me z. M. B., i njohur edhe si A. B., çka vërtetohej me përdorimin e shpeshtë gjatë vitit 2012 të automjetit me targa (***), me titullar një person të përfshirë në krimin e organizuar, konkretisht në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike, si dhe nga komunikimi i subjektit me këtë shtetas përmes numrit të telefonit të subjektit, (***), dukej se në vetëdeklarimin për figurën nuk ishin respektuar kërkesat ligjore, pasi subjekti nuk kishte deklaruar kontaktin e papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

6.12 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij, ndër të tjera, ka pretenduar se mund të ishte pyetur nëse e njihnte këtë shtetas dhe deklaroi se e njeh, pasi kanë qenë studentë në vitin 1990, dhe që nga ai vit nuk e ka takuar më. Sipas subjektit, në raportin e DSIK-së, ku thuhet se: ka pasur kontakt të papërshtatshëm sipas parashikimeve të nenit 38; nuk përcaktohet koha, forma dhe personat me të cilët është konsumuar secili prej këtyre kontakteve; ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni të faktit se ai apo vëllai i tij janë të përfshirë në krimin e organizuar; ka deklaruar se nuk ka pasur dijeni se mund të ketë qenë i dënuar në Greqi; si dhe deklaroi se formularin e vetëdeklarimit për kontrollin e figurës, parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, e

⁹ Ligji i aplikueshëm, nr. 9861, datë 24.1.2008, “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror” 5. “Kontrollet kufitare” janë kontrollet e kryera në çdo vend të kufirit, për t’u siguruar se personat, përfshirë mjetet e tyre të transportit dhe objektet që kanë me vete, plotësojnë kushtet për të hyrë apo dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë.

¹⁰ Referojuni shkresës përcjellëse datë 19.7.2019, me CD, në dosjen e Komisionit.

¹¹ Referojuni shkresës datë 20.9.2019, në dosjen e Komisionit.

ka plotësuar saktë, pasi nuk ka qenë në dijeni të faktit se personi është i përfshirë në krimin e organizuar. Nga Komisioni është thënë se është përdorur shpesh numri i telefonit për t'i telefonuar këtij shtetasi, por nuk përcaktohet se sa. Subjekti ka parashtruar se nuk e ka mohuar përdorimin e automjetit në fjalë, por se atë ia kishte marrë shtetasit M. D., i cili e kishte të një shoku të tij pasi i kishte bërë disa shërbime, duke depozituar edhe një deklaratë¹² noteriale të këtij shtetasi. Subjekti i ka kërkuar Komisionit të njihet me informacionin e klasifikuar të DSIK-së, për të cilën Komisioni e bëri me dije, sikurse referohet në pikën 7 të arsytimit të anës procedurale të këtij vendimi.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, duke pasur parasysh: (i) raportet e DSIK-së; (ii) provat shkresore dhe faktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ; (iii) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore; (iv) gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar – vlerëson se kontrolli i figurës kryhet me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016. Në zbatim të këtyre parashikimeve, në çmuarje të fakteve dhe rrethanave:

- i. Në lidhje me kontaktin e papërshtatshëm theksohet se trupi gjykues, në bazë të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, pranoi gjetjen e dërguar nga vëzhguesi ndërkombëtar, sipas së cilit shtetasi A./M. B. ka qenë i proceduar penalisht nga Gjykata e Apelit Athinë, e cila kishte urdhëruar arrestimin e tij në datën 11.5.2006, për veprën penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”. Gjithashtu, shtetasi A. B., i njohur edhe si M. B., duke filluar nga data 24.1.2014, është hetuar penalisht për veprën penale “trafikim të lëndëve narkotike” nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, ku subjekti i rivlerësimit ka punuar nga tetori i vitit 2013, e në vazhdim.
- ii. Aktiviteti i trafikimit të lëndëve narkotike konstatohet edhe nga burime të hapura, referuar *linkut* përkatës.¹³
- iii. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike, si dhe trafikimi i lëndëve narkotike përbëjnë vepra penale të “krimit të organizuar”, siç përcaktohet nga pika 15, e nenit 3, e ligjit nr. 84/2016. Në analizë të fakteve të rezultuara nga hetimi, trupi gjykues vlerëson se përdorimi i automjetit për dy vjet, 2012 dhe 2013, nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit, në pronësi të shtetasit A./M. B., nga ku sipas verifikimit të sistemit *TIMS*, jo vetëm që ka kaluar kufirin shqiptar disa herë, por edhe sipas deklaramit të subjektit se e ka përdorur këtë automjet edhe për qëllime të përgjithshme, si dhe përdorimi i numrit të telefonit (***) gjatë periudhës 15.3.2008 – më 4.2.2016, i regjistruar në emrin e subjektit, për t'i telefonuar numrit të telefonit (***), i cili ka qenë i regjistruar në emër të A. B., i njohur edhe si M. B. – përmbajnë rrethana konstatuese se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, në bazë të germave “b” dhe “c”, të pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016.
- iv. Trupi gjykues, në konsideratë të pikës 3, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar rrethanat që janë marrë parasysh në konstatim, sikurse janë besueshmëria e të dhënave

¹² Nr. (***), datë 25.10.2019, në dosjen e Komisionit.

¹³ <http://www.kavajaonline.com/forumi/topic/1610-droga-kapet-ne-greqi-cifti-shqiptar/>.

- të dala, që evidentojnë konstatimin e faktit për kontakt të papërshtatshëm në një periudhë relativisht të gjatë kohe dhe jo në mënyrë rastësore.
- v. Trupi gjykues, në raport me: deklarin e subjektit se këtë automjet ia ka marrë shtetasit M. D., të cilin e ka mik; faktin se nuk ka nënshkruar aktin e përdorimit të automjetit siç e kërkon ligji nr. 9861, datë 24.1.2008, “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, pasi rezultonte të ishte në pronësi të shtetasit B.; informacionin e administruar nga Komisioni se subjekti ka komunikuar me shtetasin B. në vitet 2008-2016 – konstaton se subjekti, me vetëdije, është shmangur nga konfirmimi i marrëdhënies me këtë shtetas. Trupi gjykues krijon bindjen se deklarimi i subjektit në tërësi bëhet i pabesueshëm dhe me qëllim shmangien e lidhjes së tij me shtetasin M. B., i njohur edhe si A. B. .
 - vi. Lidhur me deklarin e subjektit se nuk ishte në dijeni se shtetasi A./M. B. ishte i proceduar penalisht nga Gjykata e Apelit Athinë për trafikimin e lëndëve narkotike, trupi gjykues vlerëson se edhe pse nga njëra anë është në përgjegjësinë e subjektit të tregojë kujdesin e shtuar për të siguruar marrëdhëniet e krijuara mbi përdorimin e automjetit, nga ana tjetër vlerëson se mosdijenja është relevante, në varësi të rrethanave dhe, për rrjedhojë, nuk mund ta rëndojë pozitën e tij.
 - vii. Në bazë të vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të dala, trupi gjykues arriti në përfundimin se faktet e përmendura në raportet e DSIK-së, informacionet e dhëna nga institucionet përkatëse dhe konstatimet e vëzhguesit ndërkombëtar, e identifikojnë subjektin e rivlerësimit se ka kontakt me persona të përfshirë në krimin e organizuar, konkretisht në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike.
 - viii. Arritjen e këtij konkluzioni, përveç sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues e bazon edhe me krijimin e bindjes së brendshme, në informacionet dhe dokumentacionet e klasifikuara, të cilat nuk mund të përdoret në aktet publike apo të vihen në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, me përjashtim të pjesëve të deklasifikuara, për sa kohë është ligjësuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila në vendimin e datës 19.9.2017, në çështjen nr. 35289/11, - Ragner c/ Republikës Çeke¹⁴, është shprehur: “... *dhoma konkludoi se arsyet për vendimin e mospasjes akses (moszbulimit) të dokumentit në fjalë nga ana e kërkuesit ishin bazuar në interesa të sigurisë kombëtare, sepse sipas autoriteteve, zbulimi mund të kishte pasur efektin e zbulimit të metodave të punës të shërbimit të inteligjencës dhe burimet e tij të informacionit ose mund të çonin në përpjekjet e kërkuesit për të ndikuar mbi dëshmitarët e mundshëm. Sipas Dhomës, procedura e vendimmarrjes plotësonte “aq sa ishte e mundur” kërkesat e procesit të drejtë, dhe me ballafaqim, dhe barazisë së armëve në proces dhe përfshinte mbrojtje të përshtatshme të të drejtave dhe interesave të aplikantit, dhe kështu nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 i Konventës”.*
 - ix. Po në këtë kuadër, trupi gjykues çmon se, për sa i përket informacionit të klasifikuar nga institucionet verifikuese, në të cilat bazohen raportet e DSIK-së dhe që kanë rezultuar në detyrimin disiplinor në kuptimin e paragrafit 2 të Nenit 39 të Ligjit nr.

¹⁴ “...gjykatat kanë qasje të pakufizuar në të gjitha dokumentet e klasifikuara në të cilat Autoriteti është bazuar vetë në mënyrë që të justifikojë vendimin e tij. Ato kanë edhe autoritetin për të kryer një shqyrtim të hollësishtë të arsyeve të mbështetura nga Autoriteti për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara. Ata mund të vlerësojnë arsyet e dhëna për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të atyre që konsiderojnë se nuk e garantojnë atë klasifikim”, “.....e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çështjen penale ka gjetur se mund të ketë interesa konkurruese, siç është siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik të hakmarrjes ose të mbajë sekret metodat e policisë për hetimin e krimin, të cilat duhet të vlerësohen kundrejt të drejtave të palës në gjykim....”, “.... Në rastet kur provat nuk i janë vënë në dispozicion kërkuesit për arsye të interesit publik, gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, për aq sa është e mundur, t'i përmbahet kërkesave për të siguruar parimin e kontradiktoritit dhe barazisë së armëve dhe të ofrojë garanci të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personit në fjalë...”

84/2016, si dhe të Nenit “DH” të Aneksit të Kushtetutës, për aq sa trupi gjykues i përdor këto informacione për vendimmarrje klasifikimi i këtij informacioni është i justifikuar dhe subjektit i garantohet¹⁵ e drejta për t’u mbrojtur.

- Në përfundim, për sa i përket rezultatit të vlerësimit të figurës, trupi gjykues, për sa ka arsytuar, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit paraqet probleme serioze, pasi ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në bazë të germave “b” dhe “c”, të pikës 4, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016, konkretisht me shtetasin M. B., i njohur edhe si A. B. .

B. VLERËSIMI I PASURISË

ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsytuar me shkresën nr. (***) prot., datë 28.2.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personin e lidhur për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas neneve 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting”, në zbatim të nenit 31/1¹⁶, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 27.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, fakt i cili konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Gjithashtu, në referencë të nenit 32/5¹⁷ të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me numër indeksi IND (***) .

B/1 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të

¹⁵ Refero vendimin nr. 3, datë 7.2.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

¹⁶ Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, të cilën e dërgon në ILDKPKI.

¹⁷ Deklarimet e interesave privatë dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaramëve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Pasuritë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (shtojca 2) të datës 27.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

1. Për deklarinin në lidhje me apartament banimi me sip. 126.65 m², ndodhur në Rr. “(***)”, Farkë, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. (***), datë 1.8.2006, me çmim 6 500 000 lekë.

Burimi i krijimit: likuiduar nëpërmjet kredisë bankare në “Raiffeisen Bank”, lidhur me kontratën nr(***), datë 13.11.2006, shuma 5 000 000 lekë, si dhe shuma 500 000 lekë paguar *cash* nga kursimet. Mbetur pa shlyer shuma 1 000 000 lekë.

Pjesa takuese: 50 %.

Për këtë pasuri, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente¹⁸.

1.1 ILDKPKI-ja, në raportin e përcjellë, ka konstatuar: *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë, pasi pasuria është ende e palikuiduar totalisht dhe si e tillë nuk është regjistruar në ZVRPP.*

1.2 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar:

1.2.1 Në deklaratën për vitin 2006 me përshkrim “kontratë sipërmarrjeje për blerje apartamenti në Selitë, Tiranë, në vlerën 6 500 000 lekë, me kredi të marrë në “Raiffeisen Bank”, nga e cila është paguar shuma 5 500 000 lekë te sipërmarrësi, dhe ka mbetur pa shlyer shuma 1 000 000 lekë. Burimi i krijimit: kredi për blerje apartamenti me sip. 126.65 m², marrë në “Raiffeisen Bank” në shumën 5 000 000 lekë, duke nisur detyrimi prej datës 20.12.2006, sipas kontratës nr. (***), datë 13.11.2006, me interes 3 % në viti, për 25 vjet, me këst mujor 23 710 lekë, ndodhur në Selitë, Tiranë.

1.3 ZVRPP-ja Tiranë¹⁹ nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, por as edhe të personave të lidhur me të.

1.4 Nga hetimi i Komisionit lidhur me pagesat e kryera për këtë pasuri rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes nr. (***), datë 1.8.2006, me sipërmarrësin, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të ndërtimit “(***)” sh.p.k., me objekt përfitimin të apartamentit 2+1, me sipërfaqe ndërtimore 126.65 m², kati i tretë nr. 3/1, në shumën 6 500 000 lekë, apartament i ndërtuar nga sipërmarrësi për llogari të porositësit.

1.5 Sipas nenit 3 të kontratës është evidentuar se në datën e nënshkrimit është depozituar nga subjekti shuma 500 000 lekë, ndërsa shuma 5 000 000 lekë do të likuidohej pas marrjes së një kredie, dhe se vlera e mbetur prej 1 000 000 lekësh do të likuidohej brenda një periudhe gjashtë mujore nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

1.6 Nga aktet e administruara në dosjen e hetimit administrativ ka rezultuar se kredia në shumën 5 000 000 lekë është disbursuar në favor të subjektit nëpërmjet transaksionit bankar në datën 20.11.2006, nga “Raiffeisen Bank”.

¹⁸ Kontratë sipërmarrje (apartament), nr. (***), datë 1.8.2006; kontratë kredie bankare dhe hipoteke (blerje shtëpie banimi ose rikonstruksion), nr. (***), datë 13.11.2006, me “Raiffeisen Bank”, në shumën 5 000 000 lekë, me afat 300 muaj (aneks nr. 4/2)

¹⁹ Referojuni shkresës nr. (***)prot., datë 12.12.2018, në dosjen e Komisionit.

1.7 Subjekti është pyetur²⁰ lidhur me shumën 1 000 000 lekë, e cila rezulton ende e papaguar. Në përgjigjen e dhënë ka deklaruar se shuma 1 000 000 lekë vijon të mos jetë paguar, pasi pasuria ende nuk është regjistruar në ZVRPP.

1.8 Në përgjigjen²¹ e dhënë subjekti ka deklaruar se kontrata e lidhur me shoqërinë “(***)” sh.p.k., është kontratë sipërmarrjeje me kusht, referuar nenit 2 të saj, “kushti i shitjes”. Në momentin e lidhjes apartamenti nuk ishte i regjistruar në ZVRPP në emër të ndërtuesit. Fitimi i pronësisë do të realizohej pas regjistrimit të pronës në ZVRPP, fillimisht në emër të ndërtuesit dhe më pas në emrin e subjektit. Duke qenë se kontrata është e dyanshme, kësti i fundit do të paguhej në momentin kur ndërtuesi do të përmbushte detyrimin e tij të regjistrimit të apartamentit në ZVRPP. Aktualisht, ky apartament nuk është regjistruar në ZVRPP nga ndërtuesi dhe për këtë shkak, kësti i fundit nuk është paguar.

1.9 Komisioni ka kërkuar informacion edhe nga shoqëria ndërtimore, e cila ka konfirmuar²² se subjekti i rivlerësimit ka paguar për këtë pasuri shumën 5 500 000 lekë dhe i kanë mbetur pa paguar edhe 1 000 000 lekë, për shkak se pasuria ende nuk është regjistruar në hipotekë, se praktika e regjistrimit është aktualisht në hipotekë dhe se me subjektin nuk është nënshkruar ende kontrata e shitjes. Në këtë informacion shoqëria ndërtimore ka specifikuar se subjekti i rivlerësimit ka paguar shumën 500 000 lekë përpara kontratës noteriale dhe shumën 5 000 000 sipas mandatit të bankës.

1.10 Komisioni hetoi edhe në lidhje me ligjshmërinë e përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese në shumën 5 000 000 lekë, përfituar me kredinë bankare dhe me kontratën hipotekore nr(***), datë 13.11.2006, për blerje shtëpi banimi, nënshkruar midis subjektit dhe bashkëshortes së tij, znj. R. K., si dhe “Raiffeisen Bank” Tiranë.

1.11 Subjekti ka deklaruar²³ se kjo kontratë është lidhur në zbatim të marrëveshjes midis “Raiffeisen Bank” dhe Ministrisë së Financave nr. (***) prot., (MF), datë 20.6.2005, nr. (***) prot., (RBAL), datë 28.6.2005, “Mbi kreditimin nga banka të nevojave për strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, si dhe listës së miratuar nga Kryeministri. Marrëveshja është në zbatim të VKM-së nr. 102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, ndryshuar me VKM-në nr. 830, datë 10.12.2004.

1.12 Sipas VKM-së nr. 102/1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, rezulton se përfituesi i një kredie duhet të përmbushë disa kriterë ligjore ku, ndër të tjera, në pikën 2 të këtij akti nënligjor është parashikuar: *“Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqe banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti...”* Më tej, në pikën 5 është parashikuar: *“Listat për marrjen e kredive...bëhen me miratim të Kryeministrit, pas kërkesës së motivuar të ministrive dhe institucioneve përkatëse. Listat për marrjen e kredive...dërgohen në bankën e kursimeve nga Kryeministri...”*. Në pikën 6 është parashikuar: *“Kredia jepet me vlerë deri në 5 milionë lekë me interes 3 % dhe afat kthimi deri 25 vjet për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore që nuk kanë banesë...”*. Në pikën 7 të këtij

²⁰ Referojuni pyetësorit datë 31.7.2019, në dosjen e Komisionit.

²¹ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit datë 31.7.2019.

²² Referojuni shkresës datë 20.9.2019, në dosjen e Komisionit.

²³ Sipas përgjigjes nr. (***) prot., datë 5.8.2019, dhënë nga “Raiffeisen Bank” mbi kërkesën e subjektit të rivlerësimit datë 1.8.2019, depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit datë 31.7.2019, në dosjen e Komisionit.

vendimi është parashikuar: “Kredimarrësit paraqesin pranë Bankës së Kursimeve këto dokumente: Kërkesën personale, certifikatën e gjendjes familjare, dokumentin identifikues, dokumentin e vërtetimit të të ardhurave personale, aktin e blerjes së banesës, vlerësimi i të cilës është bërë nga ekspertë vlerësues të licencuar...”

1.13 “Raiffeisen Bank”²⁴ ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit figuron i 10-ti në listën e miratuar nga Kryeministri dhe të dërguar me shkresën nr(***) prot., datë 11.7.2006, për kredinë në shumën 5 000 000 lekë.

1.14 ZVRPP-ja nuk ka konfirmuar pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit në kohën e përfitimit të kësaj kredie, as edhe aktualisht.

1.15 Komisioni kreu analizën financiare për të parë mundësinë e subjektit për të investuar në këtë pasuri në shumën 500 000 lekë, si dhe për të kryer shpenzimet e tjera gjatë vitit 2006, treguesit e të cilës pasqyrohen në tabelën më poshtë.

Nr.	Përshkrimi	2006
1	TË ARDHURA	1,905,690
	Të ardhura të dokumentuara, subjekti i rivlerësimit	1,290,635
	Të ardhura të dokumentuara, bashkëshortja e subjektit	615,055
2	SHPENZIME	(5,403,605)
	Shpenzime jetese nga ILDKPKI-ja	219,114
	Shpenzime, kredia “Raiffeisen Bank” (5.000.000 lekë) (principal+interes)	(4,976,289)
	Detyrim ndaj investitorit	(1,000,000)
	Shpenzime, kredia “Raiffeisen Bank” (5.000.000 lekë) (principal+interes)	83,570
	Shpenzime arredimi	270,000
3	PASURI	6,720,280
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Blerje autoveture (bashkëshortja) “Opel Corsa”, (***)	200,000
	Kontratë sipërmarrjeje blerje ap. Selitë, Tiranë me sip. 126.65 m ² , datë 1.8.2006	6,500,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	20,280
	DIFERENCA (1-2-3)	589,015

1.16 Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor pasqyruar në tabelën e mësipërme, dukej se subjekti kishte pasur mundësi financiare për të investuar në këtë pasuri, duke paguar këstin e parë *cash* prej 500 000 lekësh, si dhe të kryejë shpenzimet e tjera familjare.

Vlerësimi i Komisionit

1.17 Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ, konstatoi se:

- i. deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhej me deklaratimet në deklaratat periodike, si dhe në provat e administruara gjatë hetimit;
- ii. subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasuri në emër të tij në kohën e përfitimit të kësaj kredie, as edhe aktualisht, sipas VKM-së nr. 102/1999, “Për trajtimin me strehim të

²⁴ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 10.10.2019, depozituar nga subjekti, në dosjen e Komisionit.

funksonarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, konstatoi se nuk rezultuan problematika për mënyrën e përfitimit të saj;

- iii. nga analiza financiare e kryer nga Komisioni rezultoi se kishte pasur mundësi financiare për të investuar në këtë pasuri duke paguar këstin e parë *cash* prej 500 000 lekësh, si dhe të kryejë shpenzimet e tjera familjare,

arrin në konkluzion se për këtë pasuri subjekti ka kryer deklarime të sakta për vërtetësinë e deklarimeve, mënyrën e përfitimit të tyre, si dhe nuk ka dyshime për ligjshmërinë e burimit të krijimit.

2. Në lidhje me depozitën në vlerën 784 606 lekë në “BKT”, krijuar nga interesat e obligacioneve.

Pjesa takuese: 100 %.

Për këtë depozitë, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁵.

2.1 Në lidhje me këtë depozitë, nga hetimi administrativ i Komisionit, në vijim të arsyetimit të sipërtrajtuar, ka rezultuar se të ardhurat e shpronësimit janë investuar në obligacione dhe se interesat e përfituara nga këto obligacione, subjekti i ka kaluar në depozitë në “BKT”.

2.1.1 “BKT”-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 7.12.2018, konfirmon depozitë në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, me gjendje shumën 784 606,70 lekë, në datën 27.1.2017.

Vlerësimi i Komisionit

2.2 Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ, arrin në konkluzionin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “BKT”-ja dhe, për rrjedhojë, nuk ka dyshime për ligjshmërinë e krijimit.

3. Në lidhje me gjendjen në llogarinë rrjedhëse me vlerë 2 376 lekë, në “BKT”.

Pjesa takuese: 100 %.

Për këtë, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.²⁶

3.1 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni kanë rezultuar faktet se:

- i. “BKT”-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 7.12.2018, konfirmon llogari rrjedhëse në shumën 2 225,71 lekë, me gjendje në datën 27.1.2017, në emër të z. Përparim Kulluri;
- ii. ndryshimi vjen si pasojë e zbritjes së komisionit për mirëmbajtjen e llogarisë, në shumën 150 lekë, po në këtë datë;
- iii. gjendja e mbetur në datën 27.1.2017 është shuma 2225,71 lekë,

për sa më sipër trupi gjykues arrin në konkluzionin se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “BKT”-ja.

²⁵ Vërtetim nr. extra prot., datë 23.1.2017, nga “BKT”-ja,; gjendja e depozitës në datën 23.1.2017, në shumën 784 606,70 lekë.

²⁶ Vërtetim nr. extra prot., datë 23.1.2017, nga “BKT”; gjendja e llogarisë rrjedhëse në datën 23.1.2017, në shumën 2 375,71 lekë (aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së).

4. Në lidhje me: gjendjen në llogarinë rrjedhëse të pagës me vlerë 3 784 lekë, në datën 27.1.2017, në “Raiffeisen Bank”; gjendjen në llogarinë rrjedhëse të pagës së bashkëshortes me vlerë 69 lekë, në datën 27.1.2017, në “Credins Bank”; detyrimet financiare për kredinë në shumën 5 000 000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, sipas kontratës nr. (***) , datë 13.11.2006, me interes 3 % në vit, me afat 25 vjet, me shumë detyrimi finance 10.4, ku “Raiffeisen Bank” ka konfirmuar gjendjen e llogarisë së kredisë në datën 27.1.2017, në shumën -3 403 127,24 lekë; gjendjen *cash* të kursime në vlerën 300 000 lekë, të vitit 2016.

- Trupi gjykues, pas analizimit të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ, arrin në konkluzion se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet bankare, si dhe për deklarimet *cash* ndër vite të subjektit dhe të ardhurave të tij dhe bashkëshortes, rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për akumulimin e gjendjes *cash* në vlerën 300 000 lekë të deklaruar në vitin 2016.

5. Në lidhje me automjetin tip “Volkswagen”, blerë nga shoqëria “(***)” sh.p.k., sipas faturës së shitjes me vlerë 21 600 euro.

Burimi i krijimit: shitje automjeti tip “Volkswagen Polo”, sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 22.2.2012, pakësim depozite me afat të datës 18.3.2011, në “Raiffeisen Bank”, si dhe kalim nga llogaria rrjedhëse e pagës. Vlera: 21 600 euro.

Pjesa takuese: 50 %.

Për këtë pasuri subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁷.

5.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën për vitin 2012 me përshkrim *“Shitje e makinës së blerë në datën 1.4.2010, në vlerën 12 000 euro, në pjesë takuese 50 %. Pakësuar depozita në “Raiffeisen Bank” në datën 18.3.2011, në vlerën 1 684 300 lekë, në pjesë takuese 50 %. Blerje makine me burim krijimi: shitja e makinës, pakësim depozite (pagat e vitit 2012), 21 600 euro, në pjesë takuese 50 %.”*

5.2 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se ky automjet është blerë sipas faturës tatimore të shitjes nr. (***) , datë 11.4.2012, nr. serial (***) , me shitës “(***)” sh.p.k., dhe blerës znj. R. K. .

5.3 Subjekti ka depozituar²⁸ dokumentacionin përkatës për pagesat e kryera, si vijon:

- mandatar-këtimin datë 25.1.2012, në shumën 5 000 euro;
- mandatar-këtimin nr(***) , datë 17.2.2012, në shumën 1 500 euro;
- *debit advice* për transaksionin nga “Raiffeisen Bank”, datë 11.4.2012, në shumën 1 684 300 lekë, konvertuar me kursin e bankës lekë/euro 139.8. Vlera: 12 048 euro;
- mandatar-këtimin për shumë 2 007 euro në “Credins Bank”, në favor të “(***)” sh.p.k., datë 11.4.2012;

²⁷ Faturë tatimore shitjeje nr. (***) , datë 11.4.2012; automjet VW Golf, nr. shasie (***) , në vlerën 21 600 euro; nxjerrje llogarie znj. R. K., në “Raiffeisen Bank”, datë 23.1.2017; nxjerrje llogarie z. Përparim Kulluri në “Raiffeisen Bank”; njoftim kreditimi “Raiffeisen Bank”, datë 12.4.2012, të shumës 1 045 euro në llogarinë e përfituesit “(***)” sh.p.k., me përshkrimin e veprimit “Diferencë për blerje makine” nga z. Përparim Kulluri; nxjerrje llogarie znj. R. K. në “Credins Bank”; faturë tërheqje nga llogaria e shumës 280 980 lekë; faturë shkëmbimi e shumës 280 980 lekë, në vlerën 2 007 euro (kursi 140); faturë derdhje në llogari të “(***)” sh.p.k., për blerje makine e shumës 2 007 euro, në datën 11.4.2012; kontratë shitjeje automjeti nr. (***) , datë 22.2.2012, në vlerën 12.000 euro. Palë shitëse znj. R. K., palë blerëse shoqëria “(***)” sh.p.k. (aneks nr. 4/5).

²⁸ Me pyetësorin e datës 31.07.2019, në dosjen e Komisionit.

- *debit advice* për transaksionin nga “Raiffeisen Bank”, në shumën 1 045 euro, datë 12.4.2012.

➤ Nga hetimi rezultoi se totali i pagesave të kryera përbënte shumën 21 600 euro.

5.4 Në lidhje me deklarinimin e burimit të këtij automjeti, Komisionit i rezultoi se:

5.4.1 Subjekti deklaronte si burim krijimi për këtë pasuri shitjen e automjetit tip “Volkswagen Polo”, sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 22.2.2012, ku palët janë: shitës R. K. dhe blerës “(***)” sh.p.k., me vlerë shitjeje 12 000 euro. Komisioni ka konstatuar se ky transaksion (datë 22.2.2012) daton pas likuidimit të dy pagesave të para të bëra në datën 25.1.2012 dhe në datën 17.2.2012. Nga hetimi rezultoi se subjekti nuk ka pasur gjendje *cash* në vitin paraardhës dhe për këtë arsye Komisioni ka hetuar mbi mundësinë financiare për të paguar shumën 6 500 euro, deri në datën 17.2.2012.

5.5 Subjekti është pyetur në lidhje me këtë mospërputhje, nga ku ka deklaruar se për shitjen e makinës “Volkswagen Polo” kishte autorizuar shtetasin D. Gj. në cilësinë e agjentit të shitjes pranë kompanisë “Volkswagen”, me prokurën e posaçme nr. (***) , datë 24.11.2011. Ai ka gjetur blerësin e makinës dhe më 25 janar 2012 ka marrë prej tij shumën 12 000 euro, që është vlera totale e shitjes së makinës, ndërkohë që veprimet noteriale janë kryer më pas. Pagesat e kryera pranë kompanisë “Volkswagen” vijnë nga kjo shumë. Subjekti ka depozituar prokurën e posaçme.

5.6 Në analizë të përmbajtjes së prokurës së posaçme rezulton se subjekti i ka dhënë të drejtë shtetasit të sipërcituar që të nënshkruajë për llogari të tij kontratën e shitjes së automjetit. Nga verifikimi i kontratës së shitjes së automjetit, nr. (***) , datë 22.2.2012, nuk rezulton që shtetasi D. Gj. të ketë ushtruar tagrin e përfaqësimit. Nën këtë analizë, dukej se deklarimi i subjektit, krahasuar me provën e depozituar, mbeti në nivel deklarativ.

5.7 Në vijim, Komisioni, duke analizuar faktet:

- që subjekti nga llogaria e tij bankare në “Raiffeisen Bank” kishte tërhequr deri në datën 17.2.2012, shumën prej 290 000 lekësh;
- që bashkëshortja e tij deri në muajin prill nuk kishte kryer asnjë tërheqje;
- duke konsideruar shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së për një muaj e gjysmë për katër persona, në shumën 70 512 lekë, si dhe këstin e kredisë në shumën 23 710,57 lekë;
- se prokura e posaçme pasqyron ekzaktësisht tagrin që duhej të kishte përfaqësuesi në kontratën e shitjes së automjetit, por që nuk rezulton ta ketë ushtruar atë,

kreu përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor për llogaritjet financiare, të cilat pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

1	Tërheqjet 1.1.2012 - 17.2.2012	290,000.00
2	Paguar deri më 17.2.2012	908,180.00
3	Shpenzimet e jetesës + kësti i kredisë	94,222.57
	Diferenca 1-2-3	- 712,402.57

5.8 Pas kryerjes së analizës financiare, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime bindëse në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, pasi në konsideratë të fakteve të arsyetuara më sipër, dukej se nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 712 402 lekë për

të paguar dy këstet e para *cash* të këtij automjeti, përkatësisht në datën 25.1.2012 dhe në datën 17.2.2012.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

5.9 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij, ndër të tjera, ka pretenduar se për kryerjen e shitjes së automjetit tip “Volkswagen Polo” me prokurën e posaçme nr. (***) , datë 24.11.2011, kishte autorizuar shtetasin D. Gj., në cilësinë e agjentit të shitjes, i cili ka disponuar automjetin dhe ka gjetur blerësin, ka negociuar çmimin në vlerën 12 000 euro, shumë e cila ishte dorëzuar nga blerësi, dorazi, në datën 25.1.2012. Ky shtetas nga shuma 12 000 euro ka mbajtur shumën 5 000 euro në formën e kaparit për blerjen e një automjeti të ri pranë kompanisë “(***)”. Për automjetin e shitur tip “Volkswagen Polo” në datën 22.2.2012, janë ndjekur procedurat e transferimit të pronësisë duke nënshkruar aktin e shitblerjes midis subjektit dhe bashkëshortes së tij, në cilësinë e palës shitëse, dhe shtetasit G. Gj., administrator i shoqërisë “(***)” sh.p.k., në cilësinë e palës blerëse. Këtë fakt e vërtetonte me deklaratën noteriale nr. (***) , datë 24.10.2019, nëpërmjet të cilës z. G. Gj., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “(***)” sh.p.k., dhe njëkohësisht blerësit të automjetit, deklaroi se automjetin e ka marrë në posedim në dhjetor të vitit 2011, pranë kompanisë “(***)” nga z. D. Gj. dhe në datën 25.1.2012 ka likuiduar *cash* në favor të këtij të fundit vlerën 12 000 euro, dhe se po në këtë datë, shtetasi Gj. ka mbajtur në formë kapari vlerën 5 000 euro, e cila do të përdorej prej palës shitëse R. dhe Përparim Kulluri për blerjen e një mjeti të ri dhe pjesën e mbetur në vlerën 7 000 euro ia ka dorëzuar *cash* palës shitëse. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale (të përbashkët) nr. (***) , datë 24.10.2019.

Vlerësimi i Komisionit

5.10 Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të cilësuar në rezultatet e hetimit, si dhe duke analizuar prapësimet dhe kontestimet e subjektit, arsyeton:

5.10.1 Verifikimi i vërtetësisë së deklarimeve dhe kontrolli i burimit të ligjshëm të të ardhurave që janë krijuar nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Polo”, sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 22.2.2012, me vlerë shitjeje 12 000 euro, është i nevojshëm pasi ndikon drejtpërdrejt në ligjshmërinë e njërit prej burimeve të krijimit të pasurisë automjet “Volkswagen”, blerë nga shoqëria “(***)” sh.p.k., sipas faturës së shitjes me vlerë 21 600 euro, pasuri e deklaruar në deklaratën “Vetting”.

5.10.2 Nga analiza e fakteve të dala nga hetimi ka rezultuar se shitja e automjetit tip “Volkswagen Polo” sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 22.2.2012, është kryer pas likuidimit të dy pagesave të para të bëra në datën 25.1.2012 dhe në datën 17.2.2012. Në këto rrethana: (i) në konsideratë të momentit të kryerjes së këtij transaksioni; (ii) mandateve të paraqitura nga vetë subjekti; (iii) faktit se subjekti vjen pa gjendje *cash* në fillim të vitit 2012 – rezultoi se subjekti është në pamundësi financiare për pagesën e dy kësteve të para.

5.10.3 Pretendimi i subjektit se agjenti kishte gjetur blerësin që në dhjetor dhe i kishte marrë në janar në dorë 12 000 euro, prej të cilave 7 000 euro ia kishte dhënë subjektit në janar dhe 5 000 euro i kishte mbajtur agjenti për kapar, nuk është bindës, pasi duket krejtësisht i pabesueshëm fakti që agjenti mbajti 5 000 euro kapar pa asnjë arsye, ndërkohë që mund të shiste automjetin për llogari të blerësit, në kohën që mori 12 000 euro, si dhe duket jo bindës deklarimi i subjektit për dhënien *cash* të shumës 12 000 euro agjentit, pa e formalizuar veprimin financiar në të njëjtën kohë, përmes nënshkrimit të një kontrate.

5.11 Ky argument mbështetet edhe nga analiza e prokurës së posaçme nr. (***) , datë 24.11.2011, të paraqitur nga subjekti. Trupi gjykues konstaton se përmes këtij akti, agjentit i ishte dhënë tagri ligjor që të përfaqësonte subjektin vetëm në nënshkrimin e kontratës së shitjes së automjetit në çdo zyrë noteriale, që në fakt shitja u realizua në shkurt të vitit 2012 dhe u nënshkrua nga subjekti dhe bashkëshortja e tij dhe jo nga agjenti.

- Nën këtë arsyetim, trupi gjykues në lidhje me këtë çështje, çmon se shpjegimet e subjektit nuk duken bindëse në kuptim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

6. Në lidhje me obligacionet, blerë nga Banka e Shqipërisë në dhjetor të vitit 2014, me burim krijimi të ardhura nga shpronësimi sipas VKM-së nr. 153, datë 19.3.2014, në shumën 7 781 000 lekë, kaluar në llogari në “BKT”.

Vlera: 6 000 000 lekë.

Pjesa takuese: 100 %.

Për këto obligacione subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.²⁹

6.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se sipas VKM-së³⁰ nr. 153, datë 19.3.2014, subjekti ka përfituar vlerën e shpërblimit 7 781 000 lekë për truall me sip. 65.2 m², shpronësim për interes publik. Kjo shumë i ka kaluar në bankë subjektit përkatësisht në datat:

- 12.5.2014, në vlerën 3 000 000 lekë, në “Credins Bank”;
- 29.9.2014, në vlerën 2 000 000 lekë, në “BKT”;
- 13.10.2014, në vlerën 2 388 838 lekë, në “BKT”;
- 19.11.2014, në vlerën 392 162 lekë, në “BKT”.

Në total **shuma 7 781 000 lekë.**

6.2 Ka rezultuar se subjekti nga këto të ardhura, shumën 6 000 000 lekë e ka investuar në obligacione në datën 2.12.2014, me afat 7 vjet, datë emetimi 9.12.2014 dhe datë maturimi 9.12.2021.

6.3 Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. (***) prot., datë 7.12.2018, ka konfirmuar blerjen e obligacioneve me vlerë 6 000 000 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

6.4 Trupi gjykues: lidhur me vërtetësinë e deklaramit në deklaratën “Vetting” dhe deklaratat periodike, në analizë të tyre, por edhe të dokumentacionit justifikues për këtë pasuri, çmon se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “BKT”-ja; lidhur me mënyrën e krijimit të obligacioneve si të ardhura të përfituara nga shpronësimi sipas VKM-së nr. 153, datë 19.3.2014, në shumën 7 781 000 lekë – ka arsyetuar në vijim në këtë vendimmarrje.

7. Në lidhje me automjetin tip “Land Rover”, sipas kontratës noteriale nr. (*) , datë 2.12.2014, me burim krijimi: shumën 1 800 000 lekë nga llogaria në “BKT” (të ardhura nga shpronësimi sipas VKM-së nr. 153, datë 19.3.2014), shumën 300 000 lekë nga pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2013 dhe diferenca kursime të vitit 2014.**

²⁹Vërtetim nr. extra prot., datë 23.1.2017, nga “BKT”; gjendja e investuar në obligacione në “BKT” është 6 000 000 lekë; vërtetim për blerje obligacioni në tregun primar datë 9.12.2014, lëshuar nga “BKT”-ja. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë datë 1.4.2014; *statement* bankar nga “BKT”-ja (aneks nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁰ Aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

Vlera: 2 400 000 lekë.

Pjesa takuese: 100 %.

Për këtë pasuri subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente.³¹

7.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën për vitin 2014 me përshkrim “*Pakësuar llogaria në ‘BKT’ për likuidim për blerje automjeti sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 2.12.2014, në shumën 1 800 000 lekë, në pjesë takuese 100 %. Blerje automjeti ‘Land Rover’, me targa (***) , në shumën 2 400 000 lekë, në pjesë takuese 100 %, sipas kontratës noteriale nr. (***) , datë 2.12.2014, me burim krijimi: transferim nga llogaria sa më sipër dhe pakësim i gjendjes cash, deklaruar në vitit 2013, si dhe kursime të vitit 2014”.*

7.2 DPSHTRR-ja, me shkresën nr. (***) prot., datë 21.11.2018 dhe shkresën nr. (***) , datë 5.12.2018, e konfirmon këtë automjet në pronësi të subjektit.

7.3 Sipas kontratës së shitblerjes së këtij automjeti ka rezultuar se pagesat janë shlyer dhe duhet të shlyheshin, konkretisht: shuma 600 000 lekë është dhënë *cash* në dorë jashtë zyrës noteriale; shuma 1 800 000 lekë do të jepej nëpërmjet “BKT”-së. Gjithashtu, nga hetimi konfirmohet pagesa e shumës prej 1 800 000 lekësh nga llogaria bankare në “BKT”, shumë kjo e siguruar nga të ardhurat e shpronësimit të pasurisë truell të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003, sipas VKM-së nr. 153, datë 19.3.2014 (këto të ardhura janë detajuar në pikën 3).

7.4 Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë e subjektit për blerjen e këtij automjeti, treguesit e të cilës pasqyrohen në tabelën më poshtë.

Nr.	Përshkrimi	2014
1	TË ARDHURA	10,332,011
	Të ardhura të dokumentuara, subjekti i rivlerësimit	1,693,322
	Të ardhura të dokumentuara, bashkëshortja	857,689
	Të ardhura nga kompensimi i dyqanit, sipas VKM-së nr. 153	7,781,000
2	SHPENZIME	1,211,736
	Shpenzime jetese nga ILDKPKI-ja	879,992
	Shpenzime kredia RFZ (5.000.000) (principal+interes)	284,527
	Shpenzime të tjera – udhëtime nga TIMS	47,217
3	PASURI	8,084,470
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Blerje automjeti “Land Rover”, (***) , datë 2.12.2014	2,400,000
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	5,684,470
	DIFERENCA (1-2-3)	1,035,805

³¹ Kontratë shitblerjeje nr. (***) , datë 2.12.2014, pasuri e luajtshme (automjet); *statement* bankar nga BKT-ja. (aneks nr. 4/3).

Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, pasqyruar në tabelën e mësipërme, dukej se subjekti kishte pasur mundësi financiare për të investuar në blerjen e këtij automjeti.

Vlerësimi i Komisionit

7.5 Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ, se:

- i. deklarimi i subjektit në deklaratën “Vetting” përputhej me deklaratimet e tij në deklaratat periodike, si dhe me provat e dala gjatë hetimit;
- ii. nga analiza financiare e kryer nga Komisioni se subjekti kishte pasur mundësi financiare për të investuar në blerjen e këtij automjeti,

arrin në konkluzionin se për këtë pasuri subjekti ka kryer deklaratime të sakta, si dhe ka pasur mundësi financiare për blerjen e saj.

8. Lidhur me mënyrën e përfitimit të shumës 1 800 000 lekë, si burim krijimi të pasurisë nr. 7, por edhe të krijimit të pasurisë nr. 6, obligacionet, si të ardhura të përfituara nga shpronësimi sipas VKM-së nr. 153, datë 19.3.2014, në shumën 7 781 000 lekë, Komisionit, nga hetimi administrativ, i ka rezultuar se:

8.1 Në deklaratën për vitin 2003 subjekti ka deklaruar pasurinë *“dyqan tregtie për artikuj industrialë, me sipërfaqe 30 m², i ndërtuar prej vitit 1994, në Orikum, Vlorë, në shumën 600 000 lekë, me burim krijimi nga të ardhurat e tij nga emigracioni, si dhe kursimet familjare.”*

8.2 Në deklaratën për vitin 2006 subjekti ka deklaruar se: *“dyqani është prishur për interes publik..., në pritje të kompensimit”*.

8.3 Në deklaratën për vitin 2014 subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shpronësimi publik sipas VKM-së nr. 153, datë 19.3.2014, në shumën 7.7 milionë lekë, shumë të cilën subjekti i rivlerësimi e ka deklaruar se e ka përdorur si burim krijimi në pasurinë e sipërcituar (makinë tip “Land Rover”) dhe (obligacione blerë nga Banka e Shqipërisë në dhjetor të vitit 2014).

8.4 Me VKM-në nr. 153, datë 19.3.2014, është miratuar në emër të subjektit të rivlerësimi shpronësimi publik për pasurinë “truall”.

8.5 Në lidhje me legjitimitetin e pronësisë së tij në pasurinë “truall” subjekti ka deklaruar: *“... trualli mbi të cilin është ndërtuar dyqani ka qenë shtetëror. Sheshi i ndërtimit është marrë me vendim të Këshillit të Komunës Orikum nr. (***) , datë 23.7.1993; me vendimin gjyqësor nr. (***) , datë 3.11.1997, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka detyruar Bashkinë Orikum ta njohë pronar për objektin dyqan; me këtë Vendim Gjyqësor është bërë regjistrimi i dyqanit në pronësi të tij, me nr. (***) , datë 27.11.1997; shpronësimi është bërë vetëm për objektin (dyqan)...”* Në lidhje me shpronësimin, subjekti deklaroi se ka pritur që pas prishjes së objektit, Bashkia Orikum ta shpronësonte, me pretendimin se është prekur nga zbatimi i projektit “Ndërtimi i shëtitores Orikum, Faza II”.

8.6 Komisioni konstatoi se me shkresën nr. (***) prot., datë 12.3.2010, Bashkia Orikum i ka kthyer përgjigje subjektit, duke e sqaruar, kërkuar dhe informuar, se:

- ka marrë të gjithë masat për të nisur procedurën e shpronësimi;
- i ka kërkuar ZVRPP-së Vlorë konfirmimin zyrtar të pronësisë së subjektit;

- i ka kërkuar subjektit vërtetimin hipotekor të rifreskuar, të shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit të pasurisë, si dokumenti kryesor për plotësimin e dosjes së shpronësimit;
- e informon se ka depozituar vetëm vërtetimin hipotekor të rifreskuar, por pa e shoqëruar me hartën treguese, por vetëm me një planrilevimi dhe, për pasojë, i bën me dije subjektit se kjo mangësi përbën pengesë për nisjen e procedurës së shpronësimit të tij;
- prona e kërkuar për shpronësim është objekt dhe për pasojë për këtë duhet domosdoshmërisht të jetë bërë një raport vlerësimi dhe se kjo bashki nuk e disponon një të tillë që gjithashtu mungesa e të cilit përbënte një pengesë serioze për nisjen e procedurës së shpronësimit.

8.7 Bashkia ka konfirmuar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit, mbi kërkesën³² e tij drejtuar një eksperti vlerësues, ka depozituar një raport vlerësimi për këtë pasuri, të përgatitur në datën 10.7.2006, për vlerësimin e pasurisë “lokal shërbimi 2 kate”.

8.7.1 Gjatë shqyrtimit Bashkia Orikum ka konstatuar këto mangësi:

- prona objekt vlerësimi është ndërtuar katër vitet e fundit (që nënkuptojnë vitet 2002 -2006), ndërsa në vërtetimin hipotekor përmendet fakti se pronësia e subjektit figuron e regjistruar në datën 27.11.1997, pra, rreth nëntë vite më parë nga momenti i bërjes së raportit të vlerësimit dhe, sipas këtij raporti, shprehet bashkia – pasuria nuk rezulton të jetë objekti që kërkohet të shpronësohet në përputhje me vërtetimin hipotekor të dorëzuar;
- pasuria sipas raportit të vlerësimit ka qenë dykatëshe, me sip. 130.4 m², ndërkohë që në vërtetimin e pronësisë të paraqitur nga subjekti pronësia rezulton me sip. 65.2 m², gjë që lë të nënkuptohet se kemi të bëjmë me dy objekte të ndryshme;
- raportit të vlerësimit nuk i është bashkëngjitur dokumenti që vërteton pronësinë mbi të cilën është bazuar eksperti për vlerësimin e saj dhe për pasojë raporti bëhet objektivisht i pavlefshëm;
- subjekti nuk ka depozituar hartën treguese e cila pasqyron vendndodhjen e pronës, si dhe mungesa e raportit të vlerësimit si dokument që nuk mund të ribëhet, pasi objekti nuk ekziston, krijon pamundësinë e nisjes së procedurës së shpronësimit.

8.8 Nën këtë arsyetim bashkia nuk ka marrë parasysh shpronësimin e pasurisë, duke krijuar bindjen se bëhet fjalë për dy objekte të ndryshme.

8.9 Rezulton se subjekti këtë përgjigje administrative e ka kundërshtuar në gjyqësor dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. (***), datë 1.12.2010, ka vendosur “shfuqizimin e këtij akti administrativ të Bashkisë Orikum dhe detyrimin e kësaj të fundit për të vijuar procedurat e shpronësimit kundrejt vlerës prej 7 781 000 lekësh pronën e subjektit të rivlerësimit”. Ky vendim është vënë në ekzekutim me Vendimin për Lëshimin e Urdhrit të Ekzekutimit nr. (***), datë 29.4.2011.

8.10 Sipas praktikës së ndjekur deri në miratimin e VKM-së, rezulton se me procesverbalin datë 5.6.2013, Komisioni i ngritur pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme ka kryer verifikimin e dokumentacionit me qëllim përfitimin e shpërblimit të shpronësimit të objektit “dyqan” për subjektin e rivlerësimit. Në këtë procesverbal vërehet se pasuria që do të shpronësohet është specifikuar e llojit “tokë truall”, me sip. 65.2 m², bazuar në vendimin nr.

³² E administruar në praktikën e shpronësimit ardhur nga Ministria e Punëve të Brendshme, në dosjen e Komisionit, si dhe në praktikën gjyqësore të depozituar nga subjekti.

(***), datë 1.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Sipas kësaj praktike rezultoi se është bërë edhe publikimi i kërkesës për shpronësim në dy gazeta, po për pasurinë “truall”.

8.11 Pas analizës së dokumenteve të sipërcituara dhe mospërputhjeve të vërejtura, Komisioni i ka kërkuar³³ shpjegime subjektit të rivlerësimit dhe në përgjigje e tij ka deklaruar se: ndërtesa e shpronësuar është ndërtim i vitit 1994; ndërtesa ka pasur sipërfaqe ndërtimi në total 65.2 m²; ndërtimi i saj ka kushtuar 600 000 lekë; nuk ka pasur pronësi mbi truallin; trualli mbi të cilin është ndërtuar dyqani ka qenë shtetëror; këtë dyqan nuk ia ka dhënë me qira askujt tjetër, përveç motrës së tij, për periudhën e deklaruar prill 2002 – mars 2003; ndërtimi është realizuar pas lejes së dhënë me vendim nr. (***) datë 23.7.1993, të Këshillit të Komunës Orikum, me lëndë “dhënie shesh ndërtimi për lokal privat”, pasi në atë kohë nuk ekzistonte Këshilli i Rregullimit të Territorit, i cili është krijuar me ligjin për Urbanistikën në vitin 1998 dhe sipas lejes nuk ka pasur sipërfaqe të përcaktuara; mbi këtë objekt nuk është bërë shtesë ndërtimi; ndërtesa duhet të jetë prishur në qershor ose në korrik të vitit 2006; fotot e ndërtesës janë në kopjen e dosjes së shpronësimit që ka depozituar më parë; nuk e ka blerë ndonjëherë truallin.

8.12 Pas vendimit të gjykatës dhe lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar Bashkisë Orikum me lajmërim për ekzekutim vullnetar, ekzekutim i cili nuk është kryer pasi Bashkia Orikum në atë vit nuk kishte fonde të mjaftueshme. Më pas, në vitin 2011 përmbaruesi ka nxjerrë urdhrin për vënien e sekuestros konservative. Në vitin 2013 bashkia i është drejtuar Ministrisë së Brendshme, Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit me kërkesë për fonde e cila është pranuar dhe me Vendimin nr. 153, datë 19.3.2014, të KM-së dhe është miratuar çelja e fondeve për efekt shpronësimi, e cila do të përballohej nga të ardhurat e Bashkisë Orikum, miratuar në buxhetin e vitit 2014.

Subjekti ka depozituar:

- kërkesën drejtuar Bashkisë Orikum për përshpejtim të procedurës së shpronësimit;
- lajmërim për ekzekutim vullnetar datë 28.10.2011;
- urdher për vënie sekuestro konservative;
- shkresë për pranim kërkesë për shpronësim, datë 26.6.2013; si dhe
- VKM-në nr.153, datë 19.3.2014.

8.13 Në analizë të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimit dhe të të dhënave të pasqyruara në raportin e vlerësimit të pasurisë së ekspertit vlerësues, përgatitur në datën 10.7.2006, pranuar nga subjekti dhe depozituar prej tij në bashkinë përkatëse, në lidhje me shpronësimin e pasurisë, Komisionit i rezultoi se:

- Dukej se kishte mospërputhje në deklaratën e subjektit për vitin 2003, në të cilën deklaroi pasurinë dyqan me sip. 30 m², me certifikatën e ZVRPP-së, që dyqani ka qenë 65.2 m², raportin e ekspertit vlerësues të përgatitur në vitin 2006, sipas të cilit pasuria ka pasur sip. 130 m². Për pasojë, dukej se subjekti nuk kishte bërë deklaram të plotë të pasurive të tij në deklaratën e vitit 2003.
- Dukej se kishte mospërputhje midis deklaratës së subjektit për vitin 2003, ku ka deklaruar se ndërtimi i kësaj pasurie ka kushtuar 600 000 lekë, dhe raportit të ekspertit vlerësues në vitin 2006, sipas të cilit ndërtimi i kësaj pasurie kishte kushtuar 3 719 268 lekë – raport ky i hartuar me kërkesën e vetë subjektit të rivlerësimit dhe i dorëzuar për llogari të tij. Për pasojë, dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar shpenzimet në vitet 2003 – 2006.

³³ Referojuni pyetësorit në tekstin e e-mail-it të datës 14.10.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

- Dukej se subjekti nuk kishte deklaruar në deklaratën për vitin 2006 ndonjë vlerë për kompensimin që priste nga shpronësimi, për pasurinë e prishur në vitin 2006, megjithë vlerësimin e bërë nga eksperti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2006, në vlerën prej 3 719 268 lekësh.
- Dukej se subjekti nuk kishte deklaruar shtesë të kësaj pasurie gjatë periudhës 2002 – 2006. Në raportin e ekspertit vlerësues të caktuar prej subjektit thuhet se objekti ishte ndërtuar gjatë kësaj periudhe kohore, raport i përpiluar me kërkesën e vetë subjektit të rivlerësimit dhe i dorëzuar për llogari të tij. Duke u mbështetur në këtë raport edhe bashkia thotë se objekti ishte ndërtuar gjatë kësaj periudhe. Për pasojë, dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte bërë deklaram të vërtetë në parashtrimet e tij gjatë procesit të shpronësimit dhe as në përgjigjet e dhëna ndaj pyetjeve të bëra nga Komisioni gjatë hetimit.
- Sipas raportit të vlerësimit, të përpiluar në vitin 2006 nga eksperti i subjektit të rivlerësimit, rezulton se subjekti ka dorëzuar kërkesë për kompensim shpronësimi për një pasuri, për të cilën nuk kishte bërë deklaramin përkatës.
- Dukej se subjekti kishte pranuar kompensim për shpronësimin në një shumë të rritur fiktivisht, në bazë të kërkesës që ka parashtruar, duke përdorur të dhëna të rreme të objektit të shpronësuar, duke paraqitur dokumentacionin në bashki, si dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Për rrjedhojë, Komisioni, i kërkoi subjektit të parashtronte argumentet e tij për sa ishte konstatuar nga Komisioni, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafin 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

8.14 Subjekti, në shpjegimet e tij³⁴, ndër të tjera, ka pretenduar:

*“Lidhur me pasurisë dyqan është e vërtetë që ka një pasaktësi në deklaramin fillestar të vitit 2003 (deklarami i parë), por kjo pasaktësi lidhet vetëm për sa i përket sipërfaqes e cila është deklaruar 30 m² (ndërkohë që është realisht e vërtetuar edhe në vërtetimin hipotekor të ZVRPP-së, e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. (***) , datë 27.11.1997, sipërfaqja ka qenë 65.2 m²). Sipërfaqja e saktë është ajo e vërtetuar me certifikatën e pronësisë lëshuar nga institucioni përkatës. Po t’i referohemi certifikatës së pronësisë, regjistrimi i kësaj prone me sip. 65.2 m² është në vitin 1997, para deklaramit fillestar (deklarami fillestar për vitin 2003). Gjithashtu, ashtu sikurse ju kam shpjeguar edhe në përgjigjet e pyetësorëve, sipërfaqja e objektit nga momenti i ndërtimit të kësaj prone, deri në momentin e prishjes viti 2006, ka qenë e njëjtë, 65.2 m², e vërtetuar kjo me vërtetimin e lëshuar nga ZVRPP-ja, sipas kërkesës nr. (***) , datë 15.10.2009, pjesë e dosjes së shpronësimit, si dhe listës së pronarëve që do të shpronësoheshin nga Bashkia Orikum në momentin e miratimit të ndërtimit të shëtitorës.*

Nuk është e vërtetë që nuk kam bërë deklaram të plotë të pasurive të mia në deklaratën e vitit 2003. Këtë pasuri që kam pasur nuk e kam fshehur dhe, për rrjedhojë, deklarata ime e atij viti është e plotë. Vlera e shpenzuar për ndërtimin e objektit dyqan është ajo e deklaruar me deklaratën fillestare (viti 2003) për 600 000 lekë dhe deri në momentin e prishjes nuk është bërë asnjë shpenzim tjetër. Referimi juaj se, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzimet në vitet 2003 – 2006, duke iu referuar vetëm raportit të ekspertit, nuk qëndron. Kanë qenë prindërit të cilët banojnë në Orikum që kanë gjetur vlerësuesin dhe aktin e kanë depozituar në

³⁴ Refero parashtrimet e subjektit, paraqitur në datën 28.10.2019.

*bashki. Sipas raportit të ekspertit, rezulton të jetë bërë vlerësim i objektit duke marrë për bazë disa tregues si: pozicionin e favorshëm, krahasimin e çmimeve në njësi të ngjashme të godinave të ndërtuara në Vlorë dhe Oriku, etj. Pra, sipas raportit nuk rezulton se evidentohen shpenzimet e kryera për ndërtimin e objektit (objekt i cili është ndërtuar që në vitin 1994), por vlerësim i objektit me metodën e kostos në momentin e prishjes (koncept i cili jepet në faqen 4 të këtij raporti). Nga ana ime është kërkuar kryerja e procedurës së shpronësimit për një objekt me sipërfaqe 65.2 m², regjistër hipotekor nr. (***), datë 27.11.1997, drejtuar bashkisë, protokolluar me nr. (***), datë 15.2.2010, kërkesë e cila ju është vendosur në dispozicion më parë.*

Për sa i përket konkluzionit se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën për vitin 2006, ndonjë vlerë për kompensimin që priste, sqaroj se ky konstatim nuk qëndron, pasi në deklaratën periodike të vitit 2006, kam deklaruar pakësim pasurie me shënimin 'Dyqani është prishur për interes publik... në pritje të kompensimit' dhe për sa kohë nuk kam marrë faktikisht ndonjë vlerë nga shpronësimi, nuk kisha çfarë të deklaroja.

*E vetmja pasuri e imja ishte dyqani që e kam ndërtuar në vitin 1994, regjistruar në vitin 1997 dhe në shkresën e saj bashkia citon vetëm aktin e ekspertit, akt i cili është hedhur poshtë dhe nuk është marrë në konsideratë. Mungesa e një raporti vlerësimi i cili duhet zyrtarisht të ishte bërë nga ana e bashkisë (trajtuar edhe në shkresën nr. (***)prot., datë 12.3.2010, të bashkisë) është bërë shkak për mosnisen e procedurës së shpronësimit. Në vijim, nga ana ime është ndjekur procedura në gjykatë për kërkimin e vlerës së objektit (regjistër hipotekor nr. (***), datë 27.11.1997) duke dorëzuar dokumentacionin përkatës. Për çeljen e procedurës gjyqësore kam nënshkruar një prokurë të posaçme ku autorizova mbrojtësin tim të më përfaqësonte në seancat që do të zhvilloheshin dhe nuk kam marrë pjesë në asnjë prej atyre seancave. Mbrojtësi më ka vënë në dijeni se akti i përpiluar nga eksperti i siguar nga familjarët e mi nuk ishte i saktë, ndaj e kam autorizuar atë të kërkojë nga gjykata kryerjen e një tjetër raport vlerësimi me një ekspert të cilin do ta caktonte gjykata, kërkesë e cila është pranuar (sipas procesverbalit seancë, datë 20.10.2010).*

Raporti i vlerësimit të ekspertit të gjykatës tregon shumë qartë sipërfaqen e objektit të shpronësuar 65.2 m², e njëjtë me atë që vërtetonte pronësinë përpara prishjes dhe që realisht ka ekzistuar. Në asnjë rast nuk kam kërkuar dhe pranuar kompensim për shpronësim në ndonjë shumë fiktive tej atij të caktuar me vendim gjykate.”

8.15 Subjekti ka paraqitur edhe një dokument të cituar “lista e pronarëve që shpronësohen nga ndërtimi i shëtitores Oriku”, dalë nga Arkiva e Zyrës së Urbanistikës, Njësia Administrative Oriku, datë 17.9.2019, ku ndër të tjera, citohet pasuria objekt 2 kate, me sip. 65.2 m², pronësi truall shtet.

Vlerësimi i Komisionit

8.16 Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të cilësuar në rezultatet e hetimit, si dhe në vështrim të prapësimeve dhe kontestimeve të subjektit, arsyeton se duke analizuar që në origjinë krijimin e pasurisë që është shpronësuar, fillimisht ka rezultuar se pasuria “dyqan” e shpronësuar, është ndërtuar në pasurinë “truall”, e cila edhe sipas deklaratimit të subjektit dhe vërtetimit nga dokumentet hipotekore nr. (***), datë 27.11.1997 (lëshuar në datën 11.12.2009 nga ZVRPP-ja Vlorë) të paraqitur prej tij, nuk ka rezultuar të jetë në pronësi të subjektit. Nga hetimi administrativ, Komisioni konstatoi se për pasurinë “truall”, nga subjekti nuk janë ndërmarrë veprime ligjore për regjistrimin e saj, pra, veprime të cilat të legjitimonin titullin e pronësisë në emër dhe për llogari të subjektit.

8.17 Në vlerësim të akteve të administruara gjatë hetimit dhe, konkretisht, përgjigjes nr. (***), datë 12.3.2010, të Bashkisë Orikum, Komisioni konstaton se të dhënat e deklaruara nga subjekti për të përfituar nga shpronësimi, tregojnë:

- i. mospërputhje midis të dhënave mbi vitet e ndërtimit se prona, objekt vlerësimi, ishte ndërtuar katër vitet e fundit, me të dhënat e pasqyruara në vërtetimin hipotekor, ku përmendet fakti se pronësia e subjektit figuron e regjistruar në datën 27.11.1997, pra, rreth nëntë vite më parë nga momenti i bërjes së raportit të vlerësimit;
- ii. mospërputhje të sipërfaqes së pasurisë prej 13.04 m², të paraqitur në raportin e ekspertit të vlerësimit të zgjedhur nga subjekti, me të dhënat e sipërfaqes prej 65.2 m², të paraqitur në vërtetimin e pronësisë të paraqitur po nga subjekti.

8.18 Mbi këto mospërputhje, Komisioni ka konstatuar se Bashkia Orikum, pas vlerësimit të bërë, nuk ka marrë parasysh shpronësimin e pasurisë, me argumentimin se bëhej fjalë për dy objekte të ndryshme, pasi: (i) ajo nuk shoqërohej me hartë treguese që të përcaktonte vendndodhjen e pasurisë; (ii) fotot e paraqitura tregonin një pasuri 2-katëshe të cilat nuk i takonin objektit që kërkohet të shpronësohej në përputhje me vërtetimin hipotekor.

8.19 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit dhe vlerësimit të bërë nga bashkia, çmon se subjekti ka paraqitur të dhëna të rreme në Bashkinë Orikum, jo vetëm për sa kohë nuk i përgjigjeshin fakteve reale të kësaj pasurie që kërkohet shpronësimi, por edhe për sa konstatohet se raporti i ekspertit vlerësues të pasurive ka të depozituar kërkesën e vetë subjektit që i kërkon ekspertit vlerësimin e pasurisë.

8.20 Lidhur me pretendimin e subjektit se raportin e vlerësimit e kanë kërkuar prindërit, trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron. Subjekti, lidhur me këtë pretendim, nuk provoi me dokument ligjor (aktperfaqësimi) ushtrimin e kësaj të drejte nga prindërit, veprim i cili lehtësisht do të pasqyrohej si në përmbajtje të kërkesës, po ashtu edhe në nënshkrimin e saj. Trupi gjykues konstaton se kërkesa identifikon në çdo rast identitetin e subjektit të rivlerësimit, pa e cituar atë si të përfaqësuar. Po ashtu, konstatohet se edhe eksperti vlerësues në dërgimin e rezultateve të raportit të vlerësimit i drejtohet subjektit të rivlerësimit dhe jo përfaqësuesve të tij, madje duke i cituar shprehimisht në hyrje të raportit: *“sipas kërkesës suaj dhe të dhënave në takimin e bërë me ju me datë 1.7.2006”*.

8.21 Trupi gjykues konstaton se këto fakte bien në kundërshtim edhe me deklarin e subjektit në seancë dëgjimore se: *“... kërkesa për vlerësim për ekspertin mbante në të vërtetë emrin e tij, por ai nuk e kishte nënshkruar, duke pretenduar se e kishin përpiluar familjarët e tij...”*.

8.22 Në këtë arsyetim, Komisioni konstaton se pikërisht akti i ekspertit vlerësues me të dhëna të pavërteta është përdorur nga subjekti për t'i dhënë vlerë provuese kërkesës për shpronësim depozituar në bashki dhe në gjyqësor.

8.22 Trupi gjykues, nga analiza e aktekspertimit të bërë nga ekspertë të caktuar nga gjykata, konstaton se rezultatet e dala, në raport me vitin e ndërtimit të pasurisë “dyqan”, nuk përkojnë me realitetin e të dhënave mbi të cilat përshkruhet dhe legjitimohet kjo pasuri. Konstatohen lehtësisht vlerësime të ndryshme të vlerës së investimit të pasurisë nga raporti i vlerësimit të pasurisë i vitit 2006 me atë të vitit 2010, megjithëse në të dy raportet mungon ekzistenca e objektit, i cili ishte shkatërruar që atëherë, megjithëse vetë subjekti në deklarime pranon se ndërtimi është bërë në vitin 1994.

8.23 Në analizë të të gjithë situatës objekt vlerësimi, duke u përqendruar te vlefshmëria e burimit të krijimit për pasurinë nr. 6 dhe 7, trupi gjykues çmon se:

8.24 Në kushtet që disponohet një vendim gjykate³⁵ i formës së prerë, i cili ka ligjësuar burimin e këtyre të ardhurave, si dhe aktit nënligjor (VKM), i cili ka ligjësuar zbatimin e vendimit gjyqësor, Komisioni gjendet në kufizim të vlerësimit të themelit të çështjes, pasi nuk mund të marrë rolin e gjykatës. Ndërkohë, për shkak të kompetencës që i jep ligji nr. 84/2016, për të hetuar dhe konkluduar mbi vërtetësinë e fakteve, rrethanave dhe deklarimeve të subjektit, në raport me të ardhurat e përfituara, sikurse ka arsyetuar gjerësisht më sipër, ka konstatuar se subjekti ka ofruar të dhëna të pavërteta lidhur me këtë pasuri, me qëllim që të siguronte në këtë mënyrë vlera më të larta përfitimi nga shpronësimi i saj, me qëllim mbështetjen dhe ligjërimin e burimit të shumës 7.8 milionë, si e ardhur nga shpronësimi.

Nën këtë arsytim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se:

- Veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, duke paraqitur të dhëna të pavërteta, me qëllim sigurimin e vlerës së lartë të përfitimit të të ardhurave nga shpronësimi i objektit “dyqan”, duke pasur parasysh pozicionin e tij si prokuror, cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti³⁶ mbi vlerësimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Raporti është mbështetur në formularin e vetëdeklarimit, tri dokumentet ligjore të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, të dhënat dhe dokumentet që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së.

Raporti, ndër të tjera, ka analizuar:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

Analiza e gjetjeve³⁷ në këtë raport i referohet, përveç sa sipër, edhe të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimeve arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga raporti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton se në tërësi për subjektin e rivlerësimit, lidhur me aftësitë profesionale dhe angazhimin personal, etikën, si dhe integritetin në ushtrim të detyrës, nuk janë konstatuar problematika, ndërsa në një dosje, nga pesë dosjet e

³⁵ Konstatohet se është një vendim në mungesë të palës së paditur, Bashkë Orikum.

³⁶ Refero raportin nr(***), datë 15.4.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

³⁷ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76, të ligjit nr. 96/2016.

përzgjedhurat me short, janë konstatuar problematika për të cilat Komisioni ka arsyetuar gjerësisht në rivlerësimin e tij profesional, si më poshtë referuar.

Gjithashtu, ky institucion, përmes raportit të tij, ka informuar Komisionin se bazuar në të dhënat arkivore, ka rezultuar që ndaj prokurorit Përparim Kulluri, me vendimin nr. (***), datë 21.9.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, është vendosur fillimi i procedimit disiplinor dhe se nuk ka vendimmarrje të Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me këtë procedim disiplinor, për të cilën Komisioni hetoi dhe arsyeton si më poshtë referuar.

RIVLERËSIMI PROFESIONAL

Komisioni, pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale kryer nga KLP-ja dhe dosjeve ku është bazuar ky raport, ka konstatuar se në tërësi për të tria dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit nuk kanë rezultuar problematika të natyrës profesionale. Po ashtu, edhe në tri³⁸ dosjet që i përkasin pesë dosjeve të shortuara nuk kanë rezultuar problematika, madje ndaj vendimmarrjeve të subjektit ka rezultuar se nuk është ushtruar ankim dhe, për pasojë vendimet kanë mbetur në fuqi sipas zgjidhjes së dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Por, Komisionit, nga aktet e administruara në fashikullin që i përket procedimit penal nr. (***)/2014 (referuar dosjes nr. (***), përfshirë në pesë dosjet e shortuara), të pushuar nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë 30.7.2015, i ka rezultuar si vijon:

- a. Çështja penale është regjistruar (nga subjekti i rivlerësimit) në datën 30.7.2014, si një çështje e adresuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shkak të ndryshimit të Kodit Penal dhe kalimit për kompetencë lëndore të çështjeve penale të hetuara për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, “korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, në Prokurorinë për Krimet e Rënda.
- b. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit në urdhërimin e tij për regjistrimin e procedimit penal, ka caktuar edhe OPGJ-në, por pa përcaktuar detyra.
- c. Ky procedim penal është regjistruar si pasojë e shkeljeve të kryera nga prokurorja e caktuar për shqyrtimin e procedimit penal nr. (***)/2012, ndaj të pandehurit F. N. .
- d. Në regjistrimin e këtij procedimi, ndër të tjera, thuhet se prokurorja A. N., në shkelje të pikës 4, të nenit 24, e vijues të Kodit të Procedurës Penale, nenit 3/b, e vijues të ligjit nr. 8337, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe urdhrin nr. (***), datë 9.5.2008, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve të prokurorit në prokurorinë e shkallës së parë”, i Prokurorit të Përgjithshëm, duke shmangur kontrollin e ligjshmërisë së drejtuesit të asaj prokurorie, ka vendosur pushimin e hetimeve për dy plagosjet me armë zjarri në ngarkim të shtetasit të sipërpërmendur e ka marrë të pandehur vetëm për veprën penale të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, ka kërkuar zëvendësimin e masës nga “arrest me burg” në “arrest shtëpie”, si dhe ka vendosur dërgimin e të pandehurit në gjyq për akuzën e ngritur.
- e. Drejtuesi i prokurorisë ka shfuqizuar aktet e mësipërme dhe më tej ka bërë zëvendësimin e prokurores dhe të OPGJ-së së çështjes.

³⁸ Kallëzimi penal nr. (***), datë 22.4.2015, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal; procedimi penal nr. (***), datë 2.4.2015, për të cilin është vendosur pushimi i tij; procedimi penal nr. (***), datë 30.7.2014, për të cilin është vendosur pushimi i tij.

- f. Në urdhrin e regjistrimit datë 26.3.2013, për veprën penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, thuhet gjithashtu se nga përmbajtja e ekstraktit nga njoftimi për kryerje të veprës penale rezulton se këto veprime janë bërë kundrejt përfitimeve të paligjshme, si dhe rezultojë të dhëna të mjaftueshme për regjistrimin e procedimit penal për këtë fakt.
- g. Në vendimin e pushimit subjekti arsyeton mbi veprime hetimore që janë kryer prej organit të prokurorisë së shkallës së parë, pasqyron përgjimet e kryera, vëzhgimet ambientale, dhe ndër të tjera, thekson se ka pasur të dhëna me interes për hetimet nga përgjimet e kryera, por nuk duket të jetë evidentuar ndonjë hetim i kryer pas marrjes dhe regjistrimit të këtij procedimi nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni, nga analiza e akteve të këtij fashikulli penal, arriti në disa konstatime dhe, për rrjedhojë, i kërkoi shpjegime subjektit, pasi:

- dukej sikur regjistrimi i këtij procedimi penal, i urdhëruar nga subjekti i rivlerësimit, ishte bërë formalisht, pasi nuk ishte kryer asnjë veprim hetimor për të konkluduar në lidhje me përfundimin e hetimit;
- dukej se nuk ishte çmuar niveli i provave të depozituara prej shfuqizimit të akteve të ndërmarra nga drejtuesi i Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, ndaj prokurores së çështjes që ndiqte procedimin penal të vitit 2012, si dhe i të gjithë provave të tjera të ndërmarra nga Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfshirë këtu përgjimet e numrave të telefonit, raportet e vëzhgimeve ambientale, si dhe mospranimi i ankimit të prokurores së kallëzuar për veprën penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” nga drejtuesi më i lartë i Prokurorisë së Përgjithshme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti në shpjegimet e tij³⁹, ndër të tjera, ka sqaruar se:

Procedimi penal, nr. (***)/2014, është regjistruar në Prokurorinë për Krime të Rënda me aktin e datës 30.7.2014, me të cilin janë pranuar aktet e procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka shpallur moskompetencën lëndore për shkak të ndryshimit të ligjit ku korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë u bë kompetencë e Gjykatës për Krimet e Rënda. Pas regjistrimit të këtij procedimi, së bashku me OPGJ-në, është kryer analiza e gjithë tabulateve telefonike, vëzhgimeve dhe, duke u nisur nga natyra e veprës penale për të cilën po hetohej, duke marrë në konsideratë se çështja e kishte humbur aktualitetin për shkak të kohës së gjatë që kishte kaluar nga kryerja e këtyre veprimeve me metoda speciale deri në regjistrimin e akteve në Prokurorinë për Krime të Rënda, është marrë informacion në lidhje me çështjen për të cilën kishte filluar ky procedim. Pra, është administruar vendimi nr. (***), datë 16.4.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, me të cilin shtetasi F. N., është deklaruar fajtor për veprat penale “vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga nenet 85 dhe 22 dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga paragrafi 2, i nenit 278, të Kodit Penal. Data e këtij vendimi është disa muaj para datës së regjistrimit të çështjes në Prokurorinë për Krime të Rënda. Prandaj nuk u çmua të delegoheshin veprime të reja hetimore, pasi ato ishin kryer që kur dosja ndodhej në Prokurorinë e Rrethit

³⁹ Refero parashtrimet e subjektit paraqitur në datë 28.10.2019.

Gjyqësor Tiranë dhe nuk kishin dhënë rezultat. Vendimi nr. (***) , datë 16.4.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është ankimuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat, ndërkohë, me vendimin nr. (***) , datë 4.6.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë është ndryshuar vendimi nr. (***) , datë 16.4.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe shtetasi F. N., është dënuar vetëm për veprën penale “mbajtje pa leje të armëve luftarake”. Një muaj më vonë pas vendimit të Gjykatës së Apelit është marrë vendimi për pushimin e çështjes.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve të konstatuara në rezultatet e hetimit, si dhe duke analizuar shpjegimet e subjektit, arsyeton:

- Subjekti, në parashtrimet e tij, qartësisht duket se pranon që nuk ka kryer hetime të mëtejshme lidhur me çështjen penale, por thjesht dhe vetëm ka verifikuar të dhënat, aktet apo veprimet e ndërmarra më parë nga organi i prokurorisë së rrethit gjyqësor dhe, po në të njëjtën mënyrë dhe formë, i ka pasqyruar ato në vendimmarrjen e tij të pushimit të këtij procedimi penal.
- Subjekti, në parashtrimet e tij, shpjegon se çështja e kishte humbur aktualitetin për shkak të kohës së gjatë që kishte kaluar nga kryerja e veprimeve me metoda speciale deri në regjistrimin e akteve në Prokurorinë për Krime të Rënda, por nuk jep asnjë argument ligjor se përse nuk e pushoi menjëherë procedimin penal, por e mbajti për një vit pa kryer asnjë veprim hetimor.
- Subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kishte pasur nën hetim një procedim penal kompleks, për të cilën i duhej kohë të hetonte dhe të vendoste.

Trupi gjykues lehtësisht konstaton nga parashtrimet e subjektit se është pritur vetëm vendimmarrja penale ndaj të pandehurit F. N., i akuzuar për veprat penale “vrasje nga pakujdesia” dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, për të cilin ishte regjistruar më pas procedimi penal i administruar nga subjekti i rivlerësimit.

Argumenti se procedimi penal është pushuar një muaj pas administrimit të vendimit penal të formës së prerë, dhënë ndaj të pandehurit të sipërcituar, nuk qëndron, pasi subjekti i rivlerësimit kishte për detyrë të hetonte në lidhje me veprën penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, konkretisht të një individi me funksion prokuror që kishte pasur lidhje me hetimin penal ndaj një të pandehuri dhe jo të lidhte ngushtësisht zgjidhjen e çështjes së tij me vendimmarrjen e gjykatës ndaj të pandehurit, pa kryer asnjë veprim hetimor për një vit radhazi.

Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka shtrirë hetimin e tij, për më tepër kur ndaj personit të akuzuar me funksion prokuror kishte vendimmarrje të zëvendësimit për vijimin e hetimeve ndaj të pandehurit nga një tjetër prokuror, si dhe kishte vendimmarrje të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili nuk kishte pranuar ankimin e paraqitur nga personi me funksion prokuror, që akuzohej në këtë procedimin penal të ndjekur nga subjekti i rivlerësimit.

Po ashtu, trupi gjykues konstaton se fashikulli administronte mjaft veprime të mëparshme hetimore, për të cilat thuhej se kishte të dhëna në dobi të hetimit, veprime apo akte të cilat kanë mbetur në të njëjtin stad, pa u hetuar më tej, madje duke u cituar në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit pa asnjë lloj arsytimi. Kjo për faktin e vetëm se subjekti i rivlerësimit ka qenë tërësisht në pamundësi të arsyetonte, për sa kohë nuk rezultoi të kishte ndërmarrë ndonjë veprim hetimor.

- Nën të gjithë argumentet dhe konstatimet e sipërpërmendura, trupi gjykues, çmon se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 73 dhe nenit 74/4, të ligjit nr. 96/2016, si dhe me “rregulloren për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, miratuar me Urdhrin nr. (***) , datë 19.11.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Në lidhje me fillimin e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit

Raporti i vlerësimit profesional ka pasqyruar faktin se me vendimin nr. (***) , datë 21.9.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm është vendosur fillimi i një procedimi disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit për mospjesëmarrje në hedhjen e shortit, për të cilin nuk ka vendimmarrje.

Komisioni hetoi në lidhje me këtë fakt dhe nga korrespondenca⁴⁰ e mbajtur me Prokurorinë e Përgjithshme rezultoi se Prokurorja e Përgjithshme, me Vendimin datë 14.12.2018, ka vendosur “mbylljen e hetimit disiplinor në ngarkim të prokurorit Përparim Kulluri”.

Në lidhje me denoncimet e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016

Në Komision janë paraqitur dy denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, përkatësisht nga shtetasit Gj. Ll.⁴¹ dhe V. Ç.⁴².

Pas shqyrtimit të parashtrimeve në to dhe dokumenteve shoqëruese, Komisionit i ka rezultuar se vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit në rastin e parë ka mbetur në fuqi, ndërsa në rastin tjetër nuk është ankimuar. Gjithashtu, në tërësi të pretendimeve të parashtruara, trupi gjykues, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

- Në përfundim, lidhur me vlerësimin profesional, trupi gjykues, duke pasur në konsideratë:⁴³ pikën 1, të nenin E, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton “*Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit*”; nenin 59, të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “*Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues*”; nenin 44, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “*Subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë...*” – arsyeton se mangësitë e konstatuara në dosjen penale nr. (***)/2014, të referuara sa më sipër, nuk janë të mjaftueshme për ta vlerësuar me mangësi profesionale, por i çmon ato në vlerësimin tërësor të subjektit.

⁴⁰ Referojuni shkresës nr. (***) prot., datë 26.9.2019, të Prokurorisë së Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

⁴¹ Nr. (***) prot., datë 7.12.2018, në dosjen e Komisionit.

⁴² Nr. (***) prot., datë 5.12.2017, në dosjen e Komisionit.

⁴³ Vendimin nr. (***) /2017, të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet: “...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)”.

Trupi gjykues, pas rekomandimit të relatorit të çështjes, për kriterin e vlerësimit profesional, në përfundim konkludon se subjekti i rivlerësimit përmbush kërkesat ligjore të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Lidhur me kontrollin e figurës, trupi gjykues vlerëson se për subjektin e rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, u arrit të provohet papërshtatshmëria për vijimin e ushtrimit të detyrës dhe, për rrjedhojë, çmon se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues çmon se:

- Për pasurinë e identifikuar nr. 5, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse në kuptim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- Në lidhje me burimin e ligjshëm të pasurive nr. 6 dhe 7, të identifikuar në pikën nr. 8, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të dhëna të pavërteta me pasojë sigurimin e vlerës së lartë të përfitimit të të ardhurave nga shpronësimi i objektit “dyqan”, si dhe ligjërimin e burimit të tyre, veprime të cilat vlerësohen si sjellje të subjektit që në raport me ushtrimin e detyrës rëndojnë pozitën e tij, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues, gjatë analizës së mangësive profesionale të konstatuara, për një rast i cili për nga rëndësia e veprës penale dhe organi hetimor i caktuar për hetimin e këtyre veprave, çmon se moskryerja e hetimeve të plota nuk identifikohet si shkak i paaftësisë profesionale të subjektit, por konkludohet se mosveprimet e subjektit në çështjen penale, e cila parimisht ndikon edhe interesin e rëndësishëm publik kur nën hetim janë persona të cilëve u janë besuar detyra të rëndësishme, dhe në rast akuzash të ngritura ndaj tyre duhet të ketë hetime intensive dhe transparente, dëshmojnë për sjellje të subjektit në mospërmbushje të detyrës në pozicionin e prokurorit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzioni PËRFUNDIMtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej tij, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, konstaton se subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, pasi rezulton me probleme serioze, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, që bën të pamundur vazhdimin e detyrës, si dhe në vlerësimin tërësor të kriterëve të rivlerësimit, ka cenuar besimin e publikut.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, mbështetur në pikat 1 dhe 3, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikën 2 të nenit 4, germën “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikat 2 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Përparim Kulluri, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.11.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Olsi Komici
Kryesues

Lulzim Hamitaj
Anëtar

Brunilda Bekteshi
Relatore

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta